

KONTRATË

Numri i kontratës:¹ **622-24-9600-5-2-1/C1551**

KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe

Grup i Operatorëve Ekonomik FLORI SH.P.K.; Qemal Krasniqi B.L., Studenqan, Suhareke, (në vazhdim "Kontraktuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punë e shënuara me poshtë:

Ndërtimi me kubza i rrugës së shkollës në fshatin Novoselan me numër identifikues: **622-24-9600-5-2-1**

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit: **Ndërtimi me kubza i rrugës së shkollës në fshatin Novoselan**

No.	Lot
1	Ndërtimi me kubza i rrugës së shkollës në fshatin Novoselan

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i punëve duhet të jetë: **51,641.05 € (pesëdhjetë e n jë mijë e gjashtëqind e dyzet e një euro e pes cent)**.

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

Marrëveshja e kontratës;

Kushtet e Veçanta të Kontratës;

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;

Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;

Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);

(Procesverbali i mbledhjes informative/vizitës së vendit)

[shëno çdo dispozitë tjetër të dosjes së tenderit].

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 4 Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin

¹ Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.


Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimi të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimi të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën ² në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Isa Osmankaj
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	04.12.2024
Vula:	

Për Kontraktuesin

Emri:	Bujar Binaku
Pozita:	Menaxher
Nënshkrimi:	
Data:	04.12.2024
Vula:	

² Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: **622-24-9600-5-2-1/C1551**

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha Shqipe .
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shuma e sigurisë së ekzekutimit është 10% i vlerës së kontratës me vlefshmëri prej 4 muaj kalendarik .
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë të tyre, materialet apo impiantin gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsye, përpos rreziqeve të definuara sipas nenit 38 të KPK, kontraktuesi korrigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkesave të menaxherit të kontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe impiantin gjer në koston e zëvendësimit të plotë; (b) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre; (c) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar. (d) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje: (i) e punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar (ii) e personave të tjerë: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim Programin për Punët brenda 3 ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është 03 ditë nga data e pranimit të kërkesës së Menaxherit të

		projektit.
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë .dy dit pas hyrjes në fuqi të kontratës
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë 40 ditë pune nga data e hyrjes në fuqi të kontratës
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.25% e Çmimit përfundimtar të Kontratës për ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10% e Çmimit final të Kontratës.
Regjistri i punës	20.1	Një regjistër i punës do të mbahen në vend-punishite nga ana e Kontraktuesit,
Inspektimi dhe testimi	22.1	Mbikqyrës i drejtpërdrejt i menaxherit të kontratës do të jetë: Çelë Lamaj Drejtor në DSHP Menaxheri i Kontratës është: Alban Krasniqi IDN në DSHP
Parapagimi		Shuma e Parapagimit është: nuk ka pagese paraprake
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: e vlerës se kontratës.
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë 3 ditë pas nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periodha garantuese e defekteve është 2 vite kalendarike pas pranimit përfundimtar të punimeve.
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve të likuiduara.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Neni 42 42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periodha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë: a) ose vendim nga gjyqi; b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK. 43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

AUTORITETI KONTRAKTUES

KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT, Remzi Ademaj, -20000, PRIZREN,

Zyrtari përgjegjes i prokurimit:

Nr i Prokurimit: 622-24-9600-5-2-1

OPERATOR EKONOMIK:

Emri i kompanisë dhe adresa e plote: **Grup i Operatorëve Ekonomik FLORI SH.P.K.; Qemal Krasniqi B.I., Studenqan, 23000, Suhareke, Kosovë**

E-mail: **florishpk2007@gmail.com**

Personi kontaktues: **Bujar Binaku**

Telefoni: **049/130924**

Faxi:

Numri fiskal:

Grup i operatorëve ekonomik (nëse aplikohet):

Partneri 1.

Emri i kompanisë: **Qemal Krasniqi B.I.**

Numri fiskal: **811284629**

Vend-Selia: **Saraqet 59/A, 20000, Prizren, Kosovë**

Partneri 2.

Emri i kompanisë: **FLORI SH.P.K.**

Numri fiskal: **600124630**

Vend-Selia: **Studenqan, 23000, Suhareke, Kosovë**

FORMULAR PËR DORËZIMIN E TENDERIT

Pjesa I. Formulari i Tenderit

Numër të Prokurimit: 622-24-9600-5-2-1

Titulli i kontratës: Ndërtimi me kubza i rrugës së shkollës në fshatin Novoselan

Si përgjigje ndaj letrës suaj të ftesës për të tenderuar për kontratën e mësipërme, ne, të poshtë nënshkruarit, deklarojmë që:

1. i kemi kontrolluar dhe pranuar plotësisht përmbajtjet e dosjes së tenderit. Ne pranojmë dispozitat e saj në tërësi, pa rezervim ose kufizim.
2. Ne ofrojmë të dorëzojmë, në pajtim me kushtet e dosjes së tenderit dhe afatet kohore të paraqitura, pa rezervë apo kufizim:

1 Ndërtimi me kubza i rrugës së shkollës në fshatin Novoselan

3. Çmimi total i tenderit është:

51,641.05 EUR

Dhe në fjalë *[shëno çmimin e tenderit në fjalë Euro]*

4. Ky tender është valid për një periudhë prej ose muaj: ose dite: **90** nga data finale për dorëzim të tenderëve.
5. Nëse tenderi jonë pranohet, ne marrim përsipër të sigurojmë një siguri të ekzekutimit para nënshkrimit të kontratës
6. Ne e bëjmë këtë kërkesë, për këtë tender *[shëno numrin e Pjesës, nëse aplikohet]* si partner në konsorcium të udhëhequr nga *[shëno emrin e udhëheqësit]*. Ne konfirmojmë që nuk jemi duke tenderuar për të njëjtën kontratë me ndonjë formular tjetër. Konfirmojmë, si partner në konsorcium, se të gjithë partnerët, bashkërisht dhe veç e veç, janë të detyruar me ligj për realizim të kontratës; se partneri kryesor është i autorizuar të obligojë dhe të marrë udhëzime për secilin anëtar dhe në emër të secilit anëtar që realizimi i kontratës, duke përfshirë edhe pagesat, është përgjegjësia e partnerit kryesor, dhe se të gjithë partnerët në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium janë të obliguar të mbeten në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium gjatë tërë periudhës së realizimit të kontratës.
7. Ne do ta informojmë Autoritetin kontraktues menjëherë nëse ka ndonjë ndryshim në rrethanat e mësipërme në cilëndo fazë gjatë implementimit të kontratës. Gjithashtu ne e dimë dhe pranojmë që të gjitha informatat e pasakta ose jo të plota të cilat jepen me qëllim në këtë konkurrim, mund të kenë si rezultat përjashtimin tonë nga kjo dhe nga kontratat tjera të financuara nga BKK
8. Theksojmë që Autoriteti kontraktues nuk është i obliguar të vazhdojë me këtë ftesë dhe që e rezervon të drejtën për të dhënë vetëm një pjesë të kontratës. Ai nuk do të shkaktojë detyrime ndaj

NDËRTIMI INFRASTRUKTURËS NË NOVOSELLË

L=582.65 m ; B= 3 m

PARAMASA DHE PARALLOGARIA

NDËRTIMI INFRASTRUKTURËS NË NOVOSELLË

Në çmimi duhet të përfshihet furnizimi i materialit, instalimi dhe sjellja e produktit në gjendje funksionale. Te gjitha produktet duhet të jenë kualitative dhe ofertuesi në ofertë të tij duhet të përfshijë certifikatat e kualitetit dhe të standarteve si dhe broshurat apo katalogjet e produkteve me të dhënat teknike të produktit me të cilat merr pjesë në tender. Kontrollimi dhe evidentimi i instalimeve nëntokësore, zgjedhja e problemeve eventuale që lidhen me planin operativ të ndërtimit si dhe përpilimi i planit detal operativ që lidhet me procesin e ndërtimit. Në çmim të llogaritet edhe kosto eventuale e detektimit me aparatura elektronike për instalime nëntokësore si dhe evidentimi i saktë i instalimeve që duhet të mirëmbahen gjatë kohës së ndërtimit dhe në rast dëmtimi të bëhet riparimi i tyre (rrjeti elektrik, rrjeti i telefonisë shtëpiake, rrjeti i ujësjellësit etj) dhe infrastruktura mbetokësore.

1 PROJEKTI I RRUGËS

1.1 INÇIZIMET DHE PUNET PARAPRAKE NË TEREN

Nr.	POZICIONI	Njësia	Sasia	Çmimi njësi me TVSH (C)	Vlera totale me TVSH (C)
1.1.2	Fiksimi i pikave kontrolluese gjeodezike si dhe sigurimi fizik i repereve të rrjetës shëtrnore për pjesën e rrugëve, nyjes me rampa dhe lëshesës sipas situacionit të dhënë. Në çmim të kalkulohet trasimi gjeodezik i rrugëve sipas profileve tërthore, vijave ku do të kalojë trotuari etj.	m'	582.67	1.00	582.67
1.1.3	Pastrimi i terrenit nga objektet ekzistuese nga dy anët e rrugës si: prerja dhe largimi i drunjeve, shkurrave dhe materialeve tjera të cilat janë në trupin e rrugës për ndërtim dhe bartja e tyre në një deponi ku e cakton organi përgjegjës i punishtes.	m ²	2330.66	2.00	4,661.32
1.1.4	Sigurimi i punishtes nga hyrjet anësore të automjeteve. Sigurimi të bëhet përmes shenjave perkatese të cilat krijojnë siguri dhe zhvillim normal të punimeve në gjithë orarin sipas kërkesave të investitorit.	m'	582.67	1.00	582.67

TOTALI:1.1

1.2 PUNET E GERMIMEVE, TRANSPORTIT DHE TË NGJASHME

Nr.	POZICIONI	Njësia	Sasia	Çmimi njësi me TVSH (C)	Vlera totale me TVSH (C)
1.2.1	Gërmimi i dheut i kategorisë II-III dhe humasin, duke përfshirë edhe kyqjet. Në çmim duhet të parashihet edhe transporti i dheut deri në një vend ku e cakton organi mbikqyrës dhe jo më pak se 10 km. Një pjesë e gërmimit duhet të përdoret për mbushje pas shqyrtimeve dhe me aprovim të organit mbikqyrës.	m ³	1,398.40	2.00	2,796.79
1.2.2	Formesimi dhe ngjeshja e nënbazës së trupit të rrugës me ngjeshmeri 30 MN/m ² , të dëshmuara me ateste, matjet duhet të bëhen me pllake rrethore qdo 50 m'.	m ²	2,330.66	2.00	4,661.32
1.2.3	Furnizimi dhe punimi i bankinave me material jokoherent, planifikim dhe ngjeshja t=10cm	m ²	291.33	2.00	582.67

TOTALI:1.2

1.3 PUNET NDËRTIMORE NË SEKSIONIN E RRUGËS

Nr.	POZICIONI	Njësia	Sasia	Çmimi njësi me TVSH (C)	Vlera totale me TVSH (C)
1.3.1	Furnizimi, transporti dhe përgatitja e shtresave mbajtëse nga guri i thyer fraksion 0-150 mm në pjesën e aksit kryesor dhe kyqeve, sipas profileve tërthore me shtresë me trashësi d=30 cm duke përfshirë edhe ngjeshjen me cilindër vibrues 25t deri në masë densiteti të kërkuar sipas normave dhe standardeve në fuqi për këtë lloj pune dhe të arrijë ngjeshmeri së paku 40 N/mm ² , të dëshmuara me ateste, matjet duhet të bëhen me pllake rrethore qdo 50 m'.	m ³	699.20	3.00	2,097.59



1.3.2	Furnizimi, transporti dhe përgatitja e shtresave mbajtëse nga guri i thyer fraksion 0-63.5 mm në pjesën e aksit kryesor dhe kyqjeve, sipas profileve tërthore me shtresa me trashësi $d=20\text{ cm}$ duke përfshirë edhe ngjeshjen me cilindër vibrues 25t deri në masë densiteti të kërkuar sipas normave dhe standardeve në fuqi për këtë lloj pune dhe të arrijë ngjeshmeri së paku 50 N/mm^2 , të ceshmuara me ateste, matjet duhet të bëhen me pllakë rrethore qdo 50 m^2	m^3	466.13	7.00	3,262.92	✓
1.3.3	Furnizimi, transporti dhe përgatitja e shtresave mbajtëse nga guri i thyer fraksion 0-31.5 mm në pjesën aksit kryesor dhe kyqjeve, sipas profileve tërthore me shtresa me trashësi $d=10\text{ cm}$, duke përfshirë edhe ngjeshjen me cilindër vibrues 25t deri në masë densiteti të kërkuar sipas normave dhe standardeve në fuqi për këtë lloj pune dhe të arrijë ngjeshmeri së paku 70 N/mm^2 , të ceshmuara me ateste, matjet duhet të bëhen me pllakë rrethore qdo 50 m^2	m^3	233.07	7.00	1,631.46	✓
1.3.4	Furnizimi, transporti, shtrirja dhe punimi i shtresës rrafshuese me rere të imët nga gurit të thyer fraksion 0-4mm adekuat për kubëza (Rizell), me trashësi të shtresës $t=5\text{ cm}$ i cili vedoset në tërë sipërfaqen e rrugës ku do të punohet me kuçza betoni	m^3	87.40	10.00	874.00	✓
1.3.5	Furnizimi, Vendosija e skajorëve 18/24/80 cm me baze betoni llogaritur me të gjitha punimet e tjera të nevojshme, kualiteti i kërkuar sipas EN1340:2003, soliditeti në lakim, min Klasa-2/T, dhe kriteret e tjera ngritje shkrije-krypëra dhe abrazion. Vërejtje në qimim kalkulohet punimi i bazamenti nga betoni i varfër, si dhe mbushja e fugave me beton të klasës C12/16. Llogaritet më m^2	m^2	1,165.33	10.00	11,653.30	✓
1.3.6	Furnizimi dhe punimi i rrugëve nga kubëzat e betonit me trashësi 8.0 cm, dhe dim. nga betoni i klases C 30/37, Dim: $20 \times 16.5 \times 8\text{ cm}$, Pesha: 5.3 kg kualiteti i kërkuar sipas EN1340:2003, dhe kriteret e tjera: ngritje-shkrije-krypëra dhe abrazion. Kubzat vendosen në bazën e rres per nivelizim me $t=5\text{ cm}$ Llog. m^2	m^2	1,800.43	10.00	18,004.35	✓
1.3.8	Ngritja (ulja) e kokave të pusëve të kanalizimit fekal, furnizimi dhe montimi i kapakeve metalik për pesha 40t. Ø600mm, ky pozicion aplikohet aty ku është e nevojshme ngritja e pusëve dhe llogaritet m^2 rrugës	Copë	10.00	25.00	250.00	✓
TOTALI: 1.3					37,773.63	✓
PARAMASA DHE PARALLOGARIA						
Në rast se projekti gjatë ekzekutimit pëson ndryshime, atëherë pas përfundimit të projektit punëkryesi duhet të hartoj projektin detal të ekzekutuar dhe ta dorëzojë të AK.						
REKAPITULIMI RRUGËS						
Nr.	Pershkrimi i pozicionit	Gjithsej				
1.1	INÇIZIMET DHE PUNET PARAPRAKE NË TEREN	€ 5,826.65				
1.2	PUNET E GERMIMEVE, TRANSPORTIT DHE TË NGJASHME	€ 8,040.78				
1.3	PUNET NDERTIMORE NË SEKSIONIN E RRUGËS	€ 37,773.63				
TOTALI + TVSH:		€ 51,641.05				





Dega PRIZREN

Numri i polices 060020120098217

1 Të dhënat për agjentin - Agent details

Emri dhe mbiemri	Adresa	Nr. i tel	Nr. ID
Melit Hysenaj-01840	Brigada 123, Nr9, Suharekë	049/286-299	002012

2 SIGURUESI / Garantuesi: Kompania e Sigurimit " SIGKOS " sh.a., Prishtinë

I SIGURUARI	FLORI SH.P.K.		
Adresa	Studenqanë/Suharekë Suhareke		
Përfaqësuar nga Z.	BUJAR BINAKU	Nr. i biznesit	810637134

3 Siguruesi dhe i siguruari me vullnet të lirë , të barabartë dhe me mirëbesim lidhin këtë lloj sigurimi.

Përshkrimi i mbulesës siguruese / Garancisë - Lloji: **SIGURIMI I EKZEKUTIMIT TË TENDERIT**

Ndertimi me kubeza i rruges se shkolles ne fshatin Novoselan. Nr. i Prokurimit: 622-24-9600-5-2-1.

a) Sigurimi i tenderit, Ekzekutimi i tenderit, Sigurim tjetër b) Titulli i mbulesës siguruese, c) Numri i prokurimit, etj.

Përfutuesi	Komuna e Prizrenit
Adresa	Remzi Ademaj Prizren
Shuma e siguruar €	5,164.10 €

4 LËNDA E GARANCISË: Detyrimet e Palëve sipas kësaj Police të Sigurimit janë:

- Mbështetur në këtë Policë- Garancie, Siguruesi/Garantuesi merrë përsipër që të plotësojë çdo detyrim kontraktor i cili është i garantuar me këtë Policë.
- Efektli veprues i kësaj Police - Garancie, që do të thotë fillimi i detyrimit të Siguruesit / Garantuesit fillon mbas përfundimit të afatit të fundit të përcaktuar në marrëveshjet dhe/ose kontratat e lidhura në mes të Siguruarit/Kontraktuesit dhe Përfutuesit që sjellin detyrimet kontraktore për kontraktuesin, që do të thotë se Përfutuesi nuk mund të paraqesë kërkesa në zbatim të kësaj Police kur Kontraktuesi është brenda afatit për përmbushjen e detyrimeve të tij ndaj Përfutuesit sipas dispozitave në fuqi.
- Përfutuesi e ka të drejtën t'i drejtohet Siguruesit/Garantuesit për marrjen e dëmshpërblimit deri në shumën e garantuar, vetëm kur detyrimet kontraktuale nuk plotësohen për faj të Siguruarit/ Kontraktuesit - Ekzekutuesit të Kontratës.
- Me plotësimin e detyrimeve ndaj Përfutuesit, Siguruesit/Garantuesit i lind e drejta që t'i drejtohet të Siguruarit / Kontraktuesit, me të gjitha mjetet ligjore, për të bërë rimbursimin e shpenzimeve të kryera në funksion të plotësimit të detyrimeve ndaj Përfutuesit (cedimi i të drejtave nga Përfutuesi tek Siguruesi / Garantuesi)

Periudha e sigurimit/garancisë Fillon me: 04.12.2024 Mbaron me: 04.12.2025

5

Shuma e siguruar	Primi neto €	TVSH	Primi total €
5,164.10 €	92.95 €	16.73 €	109.68 €

Ky Sigurim është lidhur sipas Kushteve të Përgjithshme të Sigurimit të Garancive të cilat janë pjesë përbërëse e kësaj Police.

Primi i sigurimit paguhet tërësisht
Premium is paid completely

109.68 €

Data
04.12.2024

Me këtë: Numri i kështes
In Installments: Nr. of Inst

Shënime tjera:

I Siguruari / The Insured

BUJAR BINAKU

Data e lëshimit / Issued date

04.12.2024

Siguruesi / The Insurer

Melit Hysenaj-01840



SIGURIMI I EKZEKUTIMIT TË TENDERIT

Për: **Komuna e Prizrenit**
(në vazhdim "Autoriteti Kontraktues").

Në emër të: **FLORI SH.P.K. , Studenqanë/Suharekë Suhareke**
(në vazhdim "operatori ekonomik").

Titulli i aktivitetit të prokurimit dhe Numri i prokurimit: Ndertimi me kubeza i rruges se shkolles ne fshatin Novoselan.
Nr. i Prokurimit: 622-24-9600-5-2-1.

Garancion me kërkesë të parë

DERISA operatori ekonomik i lartcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar Dosjes së Tenderit, me numër të prokurimit të lartcekur të dërguar nga Autoriteti Kontraktues;

DHE NGASE operatori ekonomik dëshiron të depozitojë sigurinë në shumën e saktësuar në Dosjen e tenderit;

DHE NGASE ne jemi pajtuar t'i japim operatorit ekonomik këtë siguri;

ANDAJ NE të poshtë nënshkruarit, me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një total prej: **Pes mije e Nje qinde e Gjashtedhjetë e Kater e Nje 5,164.10 €** zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mos përmbushja e njërit nga kushtet në vijim:

- a) Autoriteti kontraktues ka konstatuar në bazë të dëshmive të vërtetueshme objektivisht se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substanciale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë, dhe
- b) Operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe si rezultat i saj kanë mbetë pa u paguar shumë punëtorë, nënkontraktorë dhe/ose furnizues të materialeve.

Pagesa në shumën e limituar prej: **5,164.10 €** siç është lartcekur, do të bëhet pa asnjë kundërshtim as ankesë, sa më shpejt që është e mundur pas regjistrimit të kërkesës suaj me konfirmimin 'e pranimit'.

Kjo siguri është e vlefshme **365** ditë prej **04.12.2024** deri më **04.12.2025**
Garancioni në fjalë skadon tërësisht dhe në mënyrë automatike nëse kërkesa e juaj nuk ka arritur në K.S "SIGKOS" sh.a më së voni deri në datën e shënuar më lartë.



SIGKOS
KOMPANIA E SIGURIMEVE
Nënshkrimi dhe vulë e Garantuesve
[Signature]
Agjent në sigurime
Emri i bankës ose i institucionit financiar
NRB: 810111162

K.S. "SIGKOS" Sh.a.
Lagjja Kalabria, Kompleksi Riera, Hyrja Z10, Magjistrallja
Prishtinë-Shkup, 10000 Prishtinë, Kosovë

Data
04.12.2024